



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 107

Tiranë – E premte, 20 qershor 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 172, datë 30.5.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 15023
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 330, datë 11.6.2025	Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Përgjithshëm... 15023
Urdhër i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 257, datë 13.6.2025	Për shpalljen e konkurrimit për pozicionin e zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar..... 15025
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 480, datë 20.5.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Brazilit..... 15028
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 590, datë 13.6.2025	Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së murtajës së ruminantëve të vegjël..... 15028
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 591, datë 14.6.2025	Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së murtajës së ruminantëve të vegjël..... 15029
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 598, datë 16.6.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Francës..... 15030
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 599, datë 16.6.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive, të shfaqur në shtetin e Bullgarisë..... 15030

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 600, datë 16.6.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pestës së ruminantëve të vegjël të shfaqur në shtetin e Bullgarisë dhe Rumanisë.....	15031
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 8451, datë 16.6.2025	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare.....	15032
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 113, datë 3.6.2025	Mbi fillimin e procedurës lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Energovia.Albania” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	15032
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 114, datë 3.6.2025	Mbi kërkesën e shoqërisë “Zenina” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e aseteve fikse të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.....	15033
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 115, datë 3.6.2025	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a. për miratimin e “Rregullores për alokimin e kapaciteteve afatgjata”..	15034
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 116, datë 3.6.2025	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a. për miratimin “E një udhëzuesi për balancimin e energjisë elektrike”.....	15035
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 117, datë 3.6.2025	Mbi implementimin e intervalit kohor 15 minuta në operimin e proceseve në tregun e balancimit.....	15036
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 118, datë 3.6.2025	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 283, datë 18.12.2024, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Mountain’s Green Energy’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”.....	15037
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Skender Kuca.....	15039
	Kërkesë për shpalljen e zhdukjes së shtetasve Agim Birçe dhe Xhevrije Birçe.....	15039
	Korrigjim gabimi material në ligjin nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 9, datë 17.1.2025.....	15039

**DEKRET****Nr. 172, datë 30.5.2025****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:

1. Shannon Louise Robert Leslie Elliott

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

VENDIM**Nr. 330, datë 11.6.2025****PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E INSPEKTORATIT
TË PËRGJITHSHËM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 12, të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Përgjithshëm, si institucion publik, qendror, në varësi të Kryeministrit, me seli në Tiranë.

2. Inspektorati i Përgjithshëm financohet nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Misioni i Inspektoratit të Përgjithshëm është përmirësimi dhe rritja e nivelit të efektivitetit dhe përgjegjshmërisë gjatë kryerjes së veprimtarive të inspektimit në Republikën e Shqipërisë.

**II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË
INSPEKTORATIT TË PËRGJITHSHËM**

1. Inspektorati i Përgjithshëm e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror.

2. Inspektorati i Përgjithshëm kryen detyrat dhe ushtron përgjegjësitë, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

3. Inspektorati i Përgjithshëm ka përgjegjësi të organizojë punën për:

a) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave, standardeve dhe rregullave në fushën e inspektimit;

b) koordinimin dhe monitorimin e veprimtarive inspektuese për garantimin e ligjshmërisë, shmangien e mbivendosjes së kompetencave;

c) rekrutimin, performancën, disiplinën, zhvillimin e karrierës dhe trajnimin e burimeve njerëzore në fushën e inspektimit.

4. Inspektorati i Përgjithshëm nuk ushtron kompetenca inspektuese apo hierarkike mbi strukturat e vetëqeverisjes vendore, përveç rasteve të përcaktuara në mënyrë të qartë e të posaçme nga legjislacioni në fuqi.

5. Inspektorati i Përgjithshëm, kur konstaton shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës për inspektorët e të gjitha pozicioneve të punës në Inspektoratin e Përgjithshëm dhe në inspektoratet qendrore, fillon menjëherë procedurën për ngritjen e komisionit disiplinor, sipas parashikimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave, për përcaktimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisionit disiplinor.

6. Inspektorati i Përgjithshëm promovon rëndësinë e zbatimit të legjislacionit nëpërmjet fushatave ndërgjegjësuëse, botimeve, publikimeve, konferencave, seminareve, forumeve apo konsultimeve me grupet e interesit.

7. Inspektorati i Përgjithshëm përgatit e publikon në faqen zyrtare të Inspektoratit të Përgjithshëm raporte për veprimtarinë inspektuese të inspektorateve qendrore e vendore, të cilat



gjenerohen nëpërmjet sistemit elektronik “e-Inspektimi” në modulën përkatës.

8. Inspektorati i Përgjithshëm kryen vlerësime, propozon metoda e teknika inovative, që kontribuojnë në rritjen e efektivitetit dhe eficiencës në fushat e inspektimit, si dhe bashkëpunon me institucione përkatëse e analoge, vendase e të huaja, të cilat punojnë në fushat e inspektimit që mbulon.

9. Për realizimin e funksioneve të tij, Inspektorati i Përgjithshëm ka të drejtë të kërkojë të gjithë informacionin e nevojshëm për veprimtarinë e inspektorateve qendrore dhe vendore, të inspektojë dosjet e inspektimit, si dhe çdo dokument tjetër të lidhur me programimin e kryerjen e procedimeve administrative të inspektimit dhe ka të drejtë të mbikëqyrë në terren procedurën e inspektimit të inspektorateve qendrore e vendore.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I INSPEKTORATIT TË PËRGJITHSHËM

1. Veprimtaria e Inspektoratit të Përgjithshëm drejtohet nga inspektori i Përgjithshëm, i cili e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët.

2. Inspektori i Përgjithshëm mbështetet nga zëvendësinspektori i përgjithshëm.

3. Struktura dhe organika e Inspektoratit të Përgjithshëm miratohen nga Kryeministri, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

4. Marrëdhëniet e punësimit për inspektorët e Inspektoratit të Përgjithshëm rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës, dispozitave të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe akteve nënligjore, në zbatim të tij. Marrëdhëniet e punësimit për punonjësit, që ushtrojnë funksione publike dhe për punonjësit administrativë që nuk ushtrojnë një funksion publik, rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

5. Inspektori i Përgjithshëm ka këto detyra:

a) mbikëqyr zbatimin e politikave të veprimtarive inspektuese të inspektorateve qendrore, me qëllim mbrojtjen e interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë;

b) bashkërendon drejtimet strategjike dhe objektivat e inspektorateve qendrore e vendore;

c) nxjerr urdhra dhe rregullore në zbatim të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;

ç) miraton formën dhe përmbajtjen e dokumenteve standarde të procedurave të

inspektimit, me propozimin e inspektorateve qendrore, vendore dhe të strukturave të tjera inspektuese;

d) përgatit raportin vjetor të përgjithshëm të inspektimeve për inspektoratet qendrore e vendore dhe e paraqet pranë Këshillit të Ministrave dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore, brenda datës 20 (njëzet) mars të vitit pasardhës;

dh) miraton formatin e raportit vjetor të veprimtarive të inspektorateve, që i paraqitet bordit të inspektimeve, formatin e raportit të veprimtarisë inspektuese të inspektorateve qendrore e vendore, si dhe formatin e raportit të përgjithshëm vjetor të inspektimeve;

e) miraton çdo kërkesë të administruar pranë Inspektoratit të Përgjithshëm nga inspektoratet qendrore e vendore, që lidhet me zbatimin, ndryshimin apo me veprimet në sistemin unik “e-Inspektimi”.

6. Inspektori i Përgjithshëm urdhëron me shkrim dhe në formë të arsyetuar inspektoratet qendrore për fillimin e një inspektimi, në koordinim me inspektoratet vendore, për një subjekt të caktuar apo për një çështje konkrete. Urdhri për fillimin e procedurës së inspektimit, sipas kësaj pike, duhet të jetë në formë të shkruar, i motivuar dhe të përmbajë të dhëna të qarta për objektin dhe subjektin e inspektimit, bazën ligjore, si dhe qëllimin dhe kohëzgjatjen e inspektimit.

7. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Inspektoratit të Përgjithshëm miratohet nga Kryeministri, me propozimin e inspektorit të Përgjithshëm.

8. Inspektorati i Përgjithshëm identifikohet me stemën, logon dhe vulën e tij zyrtare. Stema e Inspektoratit të Përgjithshëm përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë dhe shënimet: “Republika e Shqipërisë, Kryeministria, Inspektorati i Përgjithshëm”, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 474, datë 10.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës, si dhe raportin e përmasave të saj”, të ndryshuar.

9. Vula e Inspektoratit të Përgjithshëm ka formën dhe elementet e përcaktuara në pikën 2, të vendimit nr. 390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare”, dhe shënimin identifikues “Inspektorati i Përgjithshëm”.



10. Logoja e Inspektoratit të Përgjithshëm përdoret dhe mbahet vetëm nga Inspektorati i Përgjithshëm, si mjet identifikues institucional, si dhe në kartën e inspektorit.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Inspektorati Qendror ristrukturohet në Inspektoratin e Përgjithshëm.

2. Nëpunësit civilë aktualë të Inspektoratit Qendror, të cilët kryejnë funksionet e mbikëqyrjes së inspektimeve dhe koordinimit, trajtohen sipas dispozitave kalimtare të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

3. Nëpunësit civilë aktualë të Inspektoratit Qendror, të cilët kryejnë funksionet horizontale, në kuptim të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, trajtohen sipas dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit.

4. Punonjësit aktualë të Inspektoratit Qendror, marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës, transferohen pranë Inspektoratit të Përgjithshëm, në përputhje me strukturën organizative të miratuar.

5. Procedurat për riorganizimin dhe ristrukturimin e Inspektoratit Qendror në Inspektoratin e Përgjithshëm përfundojnë brenda një afati, jo më të gjatë se 6 (gjashtë) muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Deri në fillimin e funksionimit të plotë të Inspektoratit të Përgjithshëm, Inspektorati Qendror vazhdon funksionimin e tij, sipas strukturës dhe organikës së miratuar.

7. Vendimi nr. 630, datë 14.9.2011, i Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Qendror”, shfuqizohet.

8. Ngarkohet Inspektorati i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

URDHËR

Nr. 257, datë 13.6.2025

PËR SHPALLJEN E KONKURRIMIT PËR POZICIONIN e ZËVENDËSDREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 18, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të vendimit nr. 99, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar”, të ndryshuar, të urdhrit nr. 144, datë 1.8.2024, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare dhe drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar”, të urdhrit nr. 454, datë 13.9.2019, “Për miratimin e rregullores për rregullat dhe procedurat e konkurrimit për pranimin dhe lirin nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj”, të ndryshuar, dhe të urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Orjana Osmani”,

URDHËROJ:

1. Njoftimin e fillimit të procedurës së konkurrimit për pozicionin e zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

2. Procedura e konkurrimit për pozicionin e zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, do të kryhet në përputhje me kriteret dhe dokumentacionin që duhet dorëzuar, sipas përcaktimeve të shtojcës nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

3. Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët për pozicionin e zëvendës drejtor të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar do të jetë deri në datën 27.6.2025.



4. Publikimi i kriterëve dhe procedura që do të ndiqet për konkurrimin për pozicionin e zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, të bëhet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike të Agjencisë së Prokurimit Publik.

5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTËR I MINISTRISË
SË ARSIMIT DHE SPORTIT
Orjana Osmani

SHTOJCA 1
SHPLLJE PËR POZICIONIN E
ZËVENDËSDREJTORIT TË
PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË
KOMBËTARE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës, nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 5, të kreut III, të vendimit nr. 99, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar”, të ndryshuar, të urdhrit nr. 144, datë 1.8.2024, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare dhe drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar”, dhe të urdhrit nr. 454, datë 13.9.2019, “Për miratimin e rregullores për rregullat dhe procedurat e konkurimit për pranimin dhe lirim nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj”, të ndryshuar, Ministria e Arsimit dhe Sportit shpall procedurat e konkurimit për pozicionin:

- Zëvendës drejtor i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar (AKAP) Tiranë.

I. KËRKESAT E PËRGJITHSHME QË DUHEN TË PLOTËSOHEN NGA KANDIDATËT JANË:

1. Të jetë shtetas shqiptar.

2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.

3. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.

4. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.

5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtje penale me dashje.

6. Të mos jetë larguar nga puna me masë disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

II. KËRKESAT E POSAÇME QË DUHEN TË PLOTËSOHEN NGA KANDIDATËT JANË:

1. Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve, në arsimin e lartë, në shkencat shoqërore në fushën e edukimit.

2. Të ketë të paktën 10 vjet përvojë pune në fushën e arsimit.

3. Zotërimi i gjuhëve të huaja përbëjnë avantazh (dëshmi, certifikata).

III. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>

2. Letër motivimi;

3. Diplomë Master i Shkencave ose ekuivalente me të (Për diplomat e fituara jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njësimi nga institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë);

4. Listë notash e noterizuar për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve;

5. Certifikatë për gjuhët e huaja apo kualifikime të ndryshme;

6. Librezë pune (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

7. Fotokopje e kartës së identitetit;

8. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

9. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

10. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

11. Vërtetim nga prokuroria që nuk është në ndjekje penale;

12. Vërtetim nga gjykata që nuk ka proces penal. Të gjitha dokumentet që janë fotokopje duhet të dorëzohen të njësuara me origjinalin.



Aplikimi i shoqëruar me dokumentet e sipërcituar do të dorëzohen nga kandidatët nëpërmjet shërbimit postar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, në adresën: “Rruga e Durrësit”, nr. 23, AL 1001, Tiranë.

IV. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I PUNËS PËR POZICIONIN E ZËVENDËSDREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR:

1. Zëvendësdrejtori i përgjithshëm mbështet dhe ndihmon drejtorin e përgjithshëm në organizimin dhe drejtimin e veprimtarive të AKAP-it dhe në mungesë të përkohshme të drejtorit të përgjithshëm, kryen detyrat e tij.

2. Mbikëqyr funksionimin e drejtorive dhe sektorëve pjesë përbërëse të institucionit për përmbushjen e objektivave dhe misionit të AKAP-it.

3. Informon periodikisht drejtorin e përgjithshëm mbi planet dhe realizimet e punës të drejtorive dhe sektorëve pranë AKAP-it.

4. Përgatit individualisht apo në përbërje të grupeve të punës, informacione dhe raporte.

5. Konfirmon dokumentacionin e institucionit, planet e punës të hartuara dhe realizimet mujore nga drejtoritë e AKAP-it.

V. VERIFIKIMI DHE SHQYRTIMI I DOKUMENTACIONIT DHE SHPALLJA E LISTËS PËRFUNDIMTARE

Në përfundim të afatit të aplikimit, Komisioni *ad-hoc* pas shqyrtimit të dosjeve të aplikantëve do të shpallë, brenda 3 (tri) ditëve pune listën e kandidatëve që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme, në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit: (<https://arsimi.gov.al>).

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe/ose të posaçme do të njoftohen individualisht nga njësia e burimeve njerëzore, për shkaqet e skualifikimit, nëpërmjet adresës së e-mail të deklaruar nga çdo kandidat.

Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtën e ankimit brenda 2 (dy) ditëve pune nga marrja dijeni për shkaqet e skualifikimit, nëpërmjet adresës së email-it të deklaruar prej tyre. Ankuesit do t'i kthehet përgjigje brenda 2 (dy) ditëve pune duke filluar nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

Lista përfundimtare e kandidatëve të kualifikuar do të shpallet në datën 10.7.2025, në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit:

(<https://arsimi.gov.al>). Në të njëjtën datë do të shpallet dhe njoftim për datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.

VI. FUSHAT E NJOHURIVE MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

1. Ligji nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Ligji nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

4. Ligji nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.

5. Ligji nr. 9367 datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

6. Vendimi nr. 99, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar”, të ndryshuar.

7. Vendimi nr. 621, datë 22.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”.

8. Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.1.2020, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të ndryshuar.

VII. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pikë, të cilat ndahen:

1. Vlerësimi i testimit me shkrim, deri në 60 pikë.

2. Vlerësimi për intervistën e strukturuar me gojë, deri në 25 pikë.

3. Vlerësimi për jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

Për të kaluar në fazën e intervistës së strukturuar me gojë çdo kandidat duhet të marrë të paktën 30 (tridhjetë) pikë në testimin me shkrim.

VIII. SHPALLJA E FITUESIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Fituesi do të shpallet në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit: <https://arsimi.gov.al>.



Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet nëpërmjet adresës së tyre të email-it.

URDHËR

Nr. 480, datë 20.5.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E BRAZILIT

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:
 - a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
 - b) zogjve 24-orësh;
 - c) shpendëve dekorativë;
 - ç) materialit biologjik të shpendëve;
 - d) vezëve të shpendëve;
 - dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
 - e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Brazilit, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1.	Rio Grande do Sul	Montenegro	Montenegro*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL

Anila Denaj

URDHËR

Nr. 590, datë 13.6.2025

PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJES SË MURTAJËS SË RUMINANTËVE TË VEGJËL

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, të shkronjës “b”, të nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e tregtimit të ruminantëve të vegjël në tregjet e kafshëve të gjalla, panaire dhe grumbullime të tjera.

2. Ndalimi i lëvizjes së ruminantëve të vegjël dhe specieve të tjera të mbarështuar në fermën e prekur nga sëmundja.

3. Intensifikimin e mbikëqyrjes së popullatave të ruminantëve të vegjël.

4. Forcimin e masave të biosigurisë.

5. Kafshët e llojit të imta duhet të mbarështohen sipas kërkesave shëndetësore të mbarështimit të tyre, si dhe të jenë të izoluara nga kafshët e tjera në fermë dhe të kufizohet kontakti me kafshët e tjera.

6. Intensifikimin e fushatave të ndërgjegjësimit të fermerëve, transportuesve të kafshëve, veterinerëve privatë dhe shërbimit veterinar shtetëror.

7. Masat e sipërcituara nga pika 1 deri në pikën 6 zbatohen në territorin e:



Nr.	Rrethi	Njësia administrative	Fshati
3 km			
1	Devoll	Poger	Rakicke
2	Devoll	Poger	Shyec
Totali			
10 km			
4	Korçë	Liqenas	Cerje
5	Korçë	Pojan	Burimas
6	Devoll	Proger	Mançurisht
7	Devoll	Proger	Cangonje
8	Devoll	Proger	Proger
9	Devoll	Proger	Pilur
10	Devoll	Hoçisht	Eçmenik
11	Devoll	Hoçisht	Stropan
12	Devoll	Hoçisht	Baban
13	Devoll	Bashkia Bilisht	Qendër Bilisht
14	Devoll	Qendër Bilisht	Bitinickë
15	Devoll	Qendër Bilisht	Vernik
16	Devoll	Qendër Bilisht	Tren
17	Devoll	Qendër Bilisht	Kapshicë

8. Intesifikimin e kontrollit veterinar në fermat që mbarështojnë ruminantë të vegjël dhe tregjet e kafshëve të gjalla në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 591, datë 14.6.2025

**PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE
PËR PARANDALIMIN DHE
KONTROLLIN E SËMUNDJES SË
MURTAJËS SË RUMINANTËVE
TË VEGJËL**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, të shkronjës “b”, të nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e tregtimit të ruminantëve të vegjël në tregjet e kafshëve të gjalla, panairë dhe grumbullime të tjera.

2. Ndalimi i lëvizjes së ruminantëve të vegjël dhe specieve të tjera të mbarështuar në fermën e prekur nga sëmundja.

3. Intensifikimin e mbikëqyrjes së popullatave të ruminantëve të vegjël.

4. Forcimin e masave të biosigurisë.

5. Kafshët e llojit të imta duhet të mbarështohen sipas kërkesave shëndetësore të mbarështimit të tyre, si dhe të jenë të izoluar nga kafshët e tjera në fermë dhe të kufizohet kontakti me kafshët e tjera.

6. Intensifikimin e fushatave të ndërgjegjësimit të fermerëve, transportuesve të kafshëve, veterinerëve privatë dhe shërbimit veterinar shtetëror.

7. Masat e sipërcituara nga pika 1 deri në pikën 6 zbatohen në territorin e:

Nr.	Rrethi	Njësia Administrative	Fshati
Rrezja 3 km			
1	Tiranë	Zall Bastar	Selitë mali
2	Tiranë	Zall Bastar	Bastar i Mesëm
3	Tiranë	Zall Bastar	Bastar Murriz
Rrezja 10 km			
1		Zall Bastar	Zall-Bastar
2	Tiranë	Zall Bastar	Mner i Sipërm
3	Tiranë	Kamëz	Zall-Mner
4	Tiranë	Kamëz	Bulcesh
5	Tiranë	Zall Bastar	Vilëz
6	Tiranë	Zall Bastar	Dajt
7	Tiranë	Zall Bastar	Besh
8	Tiranë	Dajt	Tujan
9	Tiranë	Zall Bastar	Shëngjin i Vogël
10	Tiranë	Dajt	Qafë-Mollë
11	Tiranë	Dajt	Qafë-Priskë
12	Tiranë	Dajt	Murth
13	Tiranë	Shën Gjergj	Domje
14	Tiranë	Dajt	Shkall
15	Tiranë	Shën Gjergj	Facesh
16	Tiranë	Shën Gjergj	Burimas
17	Tiranë	Shën Gjergj	Shëngjin
18	Tiranë	Dajt	Linzë
19	Tiranë	Dajt	Brrar
20	Tiranë	Zallbastar	Zall-Dajt
21	Dibër	Xibër	Ketë
22	Dibër	Xibër	Guri i Bardhë
23	Dibër	Xibër	Petralbe
24	Dibër	Xibër	Xibër Murriz
25	Dibër	Xibër	Xibër Hane

8. Intesifikimin e kontrollit veterinar në fermat që mbarështojnë ruminantë të vegjël dhe tregjet e kafshëve të gjalla në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti



Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 598, datë 16.6.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E FRANCËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri, për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqura në shtetin e Francës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
<i>Pays de la Loire</i>	<i>Vendée</i>	<i>La Roche-sur-Yon*</i>

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Faqe | 15030

Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 599, datë 16.6.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE
DHIVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN
E BULLGARISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës të kafshëve të llojit dhen dhe dhi nga i gjithë shteti i Bullgarisë.

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës të kafshëve të llojit dhen dhe dhi.



3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës së kafshëve të llojit dhen dhe dhi për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Urdhri nr. 547, datë 30.5.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive, të shfaqur në shtetin e Bullgarisë”, shfuqizohet.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 600, datë 16.6.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË PESTËS SË
RUMINANTËVE TË VEGJËL TË
SHFAQUR NË SHTETIN E
BULLGARISË DHE RUMANISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nga i gjithë territori i Republikës së Bullgarisë dhe Rumanisë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) kafshëve të gjalla të llojit të ruminantë të vegjël dhe ruminantë të vegjël të egër;
- b) materialit biologjik dhe embrioneve;
- c) miellit të mishit dhe miellit të gjakut, kockat pa dhjamë, thundra, kthetra dhe brirë

d) leshin, lëkurën e papërpunuar dhe lëkurën e ruminantëve të vegjël;

dh) trofetë e gjuetisë dhe preparate të destinuara për muze nga ruminantët e vegjël;

e) produktet me origjinë shtazore për përdorim farmaceutik ose kirurgjikal, të kafshëve të llojit ruminantë të vegjël.

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të ruminantë të vegjël, ruminantë të vegjël të egër, materialit biologjik, embrioneve, miellit të mishit dhe miellit të gjakut, kockat pa dhjamë, thundra, kthetra dhe brirë, leshin, lëkurën e papërpunuar dhe lëkurën e ruminantëve të vegjël, trofetë e gjuetisë dhe preparate të destinuara për muze nga ruminantët e vegjël, produktet me origjinë shtazore për përdorim farmaceutik ose kirurgjikal, të kafshëve të llojit ruminantë të vegjël.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojë të gjithë subjektet importuese të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të ruminantë të vegjël, ruminantë të vegjël të egër, materialit biologjik, embrioneve, miellit të mishit dhe miellit të gjakut, kockat pa dhjamë, thundra, kthetra dhe brirë, leshin, lëkurën e papërpunuar dhe lëkurën e ruminantëve të vegjël, trofetë e gjuetisë dhe preparate të destinuara për muze nga ruminantët e vegjël, produktet me origjinë shtazore për përdorim farmaceutik ose kirurgjikal, të kafshëve të llojit ruminantë të vegjël.

4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi më datë 18.6.2025 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

**NJOFTIM****Nr. 8451, datë 16.6.2025****MBI HYRJEN NË FUQI TË
MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE**

“Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Pyjeve të Republikës së Turqisë për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe zonave të mbrojtura”, nënshkruar në Ankara, më 20.2.2024, hynë në fuqi më 2 qershor 2025.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

VENDIM**Nr. 113, datë 3.6.2025****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR
ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “ENERGOVIA.ALBANIA”
SHPK PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1, germa “e” dhe 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordin i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.6.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1693/5 prot., datë 28.5.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Energovia.Albania’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Energovia.Albania” sh.p.k. paraqiti në ERE kërkesë për njohjen e licencës për furnizim me energji elektrike, lëshuar nga Agjencia Serbe e

Energjisë. Pas konfirmimit nga autoriteti serb se nuk është kompetent për njohjen e licencave të huaja, subjekti tërhoqi kërkesën dhe paraqiti aplikim të ri për licencim në tregtim energjie.

- ERE informoi subjektin mbi dokumentacionin dhe pagesat e nevojshme. Dokumentacioni i plotë u dorëzua më 12 maj 2025, ndërsa pagesa u verifikua më 28 maj 2025. Në këto kushte, konsiderohet e drejtë nisja e procedurës formale për shqyrtimin e aplikimit për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i aplikimit dhe në përputhje me përcaktimet e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, rezultoi se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pikat 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisje me licencë, duke plotësuar formularin sipas formatit të shtojcës 1 dhe deklaruar të dhënat e subjektit. Shoqëria ka konfirmuar angazhimin për respektimin e kuadrit ligjor dhe rregulloreve të ERE-së, si dhe ka kryer pagesën e mbetur më 15.5.2025, në përputhje me aneksin A të rregullores.

- Sipas nenit 9, pika 1.2, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ, përfshirë ekstraktin historik të regjistrit tregtar të vulosur nga QKB-ja më 29.4.2025, ku rezultoi se shoqëria është regjistruar më 12.2.2024 si sh.p.k., me administrator dhe ortak z. T. A. Gjithashtu, është dorëzuar autorizimi noterial për përfaqësim, i përkthyer në gjuhën shqipe, i cili autorizon përfaqësues të shoqërisë për kryerjen e veprimeve në ERE dhe institucione të tjera shtetërore.

- Në përputhje me pikën 1.3, janë dorëzuar dokumentacioni financiar dhe fiskal, përfshirë pasqyrat financiare 2024, mbështetjen financiare për një muaj aktivitet, bilanci financiar të shoqërisë mëmë për vitet 2021–2023, si dhe plani i biznesit 2025–2029 me parashikime financiare për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në bazë të pikës 2.5, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në aktivitetin e tregtimit, duke paraqitur parashikimin e sasive të energjisë elektrike që synon të tregtojë gjatë periudhës pesëvjeçare të vlefshmërisë së licencës.



Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:
Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë dëshminë e penalitetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për administratorin dhe në rast se ai nuk ka rezidencë në Shqipëri, duhet të depozitohet vërtetimi i gjendjes gjyqësore të lëshuar nga autoritetet përkatëse të vendit të tij të rezidencës;

- germa “c”: Duhet të sqarohet se cila është struktura aktuale organizative e shoqërisë “Energovia.Albania” sh.p.k., të depozitohet sipas formës ligjore dhe, po ashtu, të depozitohet dokumentacioni përkatës për shërbimet e jashtme (si p.sh., kontratat e shërbimit).

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa “a”: Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e përditësuar për shlyerjen e detyrimeve ndaj tatimeve dhe vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve ndaj institucioneve të sigurimeve shoqërisë dhe shëndetësore.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Energovia.Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Energovia.Albania” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 114, datë 3.6.2025

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ZENINA” SHPK PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E ASETVE FIKSE TË SAJ SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, germa “b” të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e Entit Rregullator të Energjisë”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.6.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1618/3 prot., datë 29.5.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Zenina’ sh.p.k. për dhënie autorizimit nga ERE për vendosjen e aseteve të paluajtshme të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”,

konstatoi se:

- Më datë 28.4.2025, shoqëria “Zenina” sh.p.k., e licencuar nga ERE për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin nr. 25, datë 27.1.2025, të Bordit të ERE-s, ka paraqitur kërkesë pranë ERE-s për konfirmim dhe udhëzime në lidhje me marrjen e autorizimit për transferimin e aseteve fikse dhe barrësimin e kuotave të saj, në funksion të marrëveshjeve të lidhura me “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a.

- Në përgjigje, ERE ka sqaruar se, në zbatim të pikës 1 të nenit 44 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe të nenit 4, germa “b”, të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin nr. 119, datë 21.7.2016, të Bordit të ERE-s, miratimi nga ERE kërkohet vetëm në rastet kur vlera e aseteve tejkalon shumën 150.000.000 lekë.

- Pas depozitimit të dokumentacionit nga ana e shoqërisë, konstatohet se vlera e aseteve që kërkohen të transferohen është nën kufirin e përcaktuar në kuadrin rregullator më sipër cituar.



Për rrjedhojë, vlerësohet se kërkesa nuk është objekt i shqyrtimit nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos marrë në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “Zenina” sh.p.k. për dhënien e autorizimi nga ERE për vendosjen e aseteve fikse të saj si mjet për garantimin e detyrimeve ndaj “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Zenina” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 115, datë 3.6.2025

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË OST SHA PËR MIRATIMIN E “RREGULLORES PËR ALOKIMIN E KAPACITETEVE AFATGJATA”

Në mbështetje të neneve 16, 19 germa “e”, 20, germa “a”, 23, pika 1, germa “a”, 65, pika 1, dhe 66, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016 të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE); Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.6.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1407/1 prot., datë 21.5.2025, të përgatitur nga drejtoritë teknike, “Mbi fillimin e procedurës për

shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a. për miratimin e “Rregullores së alokimit të kapaciteteve afatgjata”, konstatoi se:

- Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. ka depozituar në ERE, me shkresën nr. 1752 prot., datë 20.3.2025, kërkesën për miratimin e “Rregullores për alokimin e kapaciteteve afatgjata”.

- Në këtë kërkesë, OST-ja nënvizon, se në përputhje me vendimin nr. 2022/03/MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë, janë përfshirë në *Acquis Communautaire* të Traktatit një sërë aktesh rregullatore të BE-së, përfshirë rregulloren (BE) 2016/1719 të Komisionit Evropian “Për miratimin e udhëzuesit për alokimin e kapaciteteve afatgjata (FCA Guideline)”, pjesë e Paketës së Energjisë së Pastër për të Gjithë Evropianët.

- Projektregullorja synon të krijojë një kornizë të harmonizuar për alokimin ndërkuftar të të drejtave të transmetimit në periudha afatgjata, përmes metodologjive të harmonizuara dhe ankandeve të përbashkëta evropiane. Ajo përfshin rregulla për llogaritjen dhe ndarjen e kapaciteteve, zhvillimin e ankandeve, kompensimet dhe rikuperimin e kostove.

- Zbatimi i kësaj rregulloreje është një hap i rëndësishëm drejt integritetit të Shqipërisë në tregun rajonal dhe evropian të energjisë elektrike, duke rritur transparencën, efikasitetin dhe sigurinë e tregut afatgjatë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullores së alokimit të kapaciteteve afatgjata”.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.



Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 116, datë 3.6.2025

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË “OST”
SHA PËR MIRATIMIN “E NJË
UDHËZUESI PËR BALANCIMIN E
ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a” dhe “ç”, 23, pika 1, germa “a”, 100, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016 të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE); Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.6.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1672/1 prot., datë 28.5.2025, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së ‘OST’ sh.a. për miratimin e rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, datë 23 nëntor 2017, ‘Për miratimin e Udhëzuesit për Balancimin e Energjisë Elektrike’”,

konstatoi se:

- Shoqëria “OST” sh.a., me shkresën nr. 2580 prot., datë 30.4.2025, protokolluar në ERE me nr. 1672 prot., datë 5.5.2025, ka depozituar kërkesën për miratimin e rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, datë 23.11.2017, mbi Udhëzuesin për Balancimin e Energjisë Elektrike.

- Në këtë kërkesë, “OST” sh.a. informon se Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë, në mbledhjen e datave 14–15 dhjetor 2022, ka miratuar vendimin nr. 2022/03/MC-EnC, përmes të cilit kjo rregullore është përfshirë në *acquis communautaire* të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, si pjesë e Paketës së Energjisë së Pastër.

- Rregullorja (BE) 2017/2195, e njohur si Udhëzuesi për Balancimin e Energjisë Elektrike (EBGL), përcakton një kornizë të përbashkët për funksionimin e tregjeve të balancimit në nivel evropian, me synimin për të rritur efikasitetin,

konkurrencën dhe transparencën në treg, si dhe për të garantuar sigurinë e furnizimit.

- Rregullorja vendos rregulla për mënyrën e planifikimit, prokurimit, aktivizimit dhe shlyerjes së rezervave të balancimit nga Operatorët e Sistemeve të Transmetimit (OST), si dhe për përdorimin e rezervave zëvendësuese në rast të pamjaftueshmërisë së burimeve ekzistuese të balancimit.

- Gjithashtu, ajo përfshin dispozita për shkëmbimin ndërkufitar të energjisë së balancimit, format e pjesëmarrjes në treg për të gjithë aktorët përkatës dhe detyrime për bashkëpunim dhe raportim të të dhënave, me qëllim rritjen e transparencës dhe funksionimin e qëndrueshëm të tregjeve.

- Në përputhje me legjislacionin e Komunitetit të Energjisë dhe nevojën për harmonizim me rregullat e BE-së, ERE vlerëson të nevojshme nisjen e procedurës për shqyrtimin e kërkesës dhe organizimin e seancave dëgjimore dhe konsultimeve me palët e interesuara, përfshirë institucionet dhe aktorët e tregut të energjisë, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e “Udhëzuesit për balancimin e energjisë elektrike” miratuar me rregulloren e Komisionit (BE) 2017/2195, datë 23 nëntor 2017.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 117, datë 3.6.2025

MBI IMPLEMENTIMIN E INTERVALIT
KOHOR 15 MINUTA NË OPERIMIN E
PROCESEVE NË TREGUN E
BALANCIMIT

Në mbështetje të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 104, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.6.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1203/3 prot., datë 30.5.2025, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike “Mbi implementimin e intervalit kohor 15 minuta në operimin e proceseve në tregun e balancimit”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 45, datë 27.2.2025, vendosi: “zgjatjen e efekteve juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 148, datë 25.7.2024, deri më 11.6.2025, si dhe “OST” sh.a. të raportojë çdo 15 (pesëmbëdhjetë) ditë në ERE dhe të kryejë testimet përkatëse me pjesëtarët e tregut, operatorët e bursës dhe me OST-të fqinje për implementimin e intervalit kohor 15-minutësh.”.

- ERE, me shkresën nr. 1203/2 prot., datë 3.3.2025, njoftoi Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) sh.a., shoqërinë “Devoll Hydropower” sh.a., shoqërinë “Ayen AS Energji” sh.a., Shoqatën Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), Furnizuesin e Tregut të Lirë (FTL) sh.a., Shoqatën e “Prodhuesve të Energjisë deri në 2mw”, Shoqatën Shqiptare të Energjisë së Rinovueshme (AREA), “ALPEX” sh.a., si dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. mbi vendimin e Bordit të ERE-s nr. 45/2025.

- “OST” sh.a., në zbatim të pikës 2, të vendimit nr. 45/2025, ka bërë raportimet çdo 15 (pesëmbëdhjetë) ditë mbi testimet për implementimin e intervalit kohor 15-minutësh me shkresat e protokolluara në ERE me (nr. 1406 prot., datë 25.3.2025, nr. 1528 prot., datë 14.4.2025, nr.

1642 prot., datë 29.4.2025, nr. 1724 prot., datë 19.5.2025, nr. 1773 prot., datë 27.5.2025).

- Nëpërmjet komunikimeve zyrtare të datës 25.4.2025 dhe 9.5.2025, ERE është informuar nga “OST” sh.a., lidhur me vështirësitë që po hasen në procesin e testimit nga Palët Përgjegjëse të Balancimit (PPB) dhe Ofruesit e Shërbimeve Balancuese (OSHB). Konkretisht, OST-ja ka raportuar mungesë angazhimi në deklarinimin dhe përpunshmërinë e nominimeve në mjedisin testues të Platformës së Menaxhimit të Tregut, në kundërshtim me kërkesat rregullatore në fuqi. Si pasojë, proceset e skedulimit *Long-Term* dhe *Day-Ahead*, si dhe hapat pasues të tyre, nuk mund të përmbillen në mënyrë të rregullt.

- Duke marrë në konsideratë sa raportuar nga “OST” sh.a., ERE ka njoftuar palët e përfshira për zhvillimin e një seance dëgjimore më datë 12.5.2025, me synim diskutimin mbi ecurinë e implementimit dhe mbledhjen e komenteve nga të gjithë aktorët e tregut.

- Në seancën e mbajtur pranë ERE-s, më 12.5.2025, morën pjesë përfaqësues të “OST” sh.a., “FTL” sh.a., “KESH” sh.a., shoqatave “AREA” dhe “AAES”, si dhe të “Devoll Hydropower” sh.a. Disa prej pjesëmarrësve, përfshirë OST-në, FTL-në dhe Devoll Hydropower, konfirmuan gatishmërinë për kalimin në intervalin kohor 15-minutësh. Ndërkohë, përfaqësues të tjerë kërkuan shtyrjen e afatit të implementimit, kërkesa të cilat janë paraqitur zyrtarisht edhe pranë ERE-s.

- AREA, nëpërmjet një kerkese të protokolluar më datë 12.5.2025, paraqiti problematika të konstatuara nga prodhuesit me përparësi dhe kërkoj zgjatjen e fazës “*dry run*” për të mundësuar adresimin e çështjeve të disbalancave dhe përgatitjen e tregut për funksionim të plotë në regjim 15-minutësh.

- “KESH” sh.a., me shkresën e datës 19.5.2025, kërkoj shtyrjen e implementimit deri në fund të vitit 2025, ndërsa shoqata “AAES”, më 23.5.2025, propozoi zgjatjen e afatit deri më 31 dhjetor 2025 për proceset në Tregun e Balancimit.

- “FTL” sh.a., me shkresën e datës 27.5.2025, nënvizon vështirësitë teknike që lidhen me rritjen e ndjeshme të volumit të të dhënave dhe kompleksitetin në nominimin në kohë të programeve si pasojë e kalimit në këtë regjim të ri.

- Shoqëritë “ALPEX” dhe “OST” janë aktualisht pjesë e projektit për bashkimin e tregut ndërmjet Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe



Greqisë. Në këtë kontekst, dhe meqenëse Greqia është pjesë e mekanizmit SDAC të BE-së, Shqipëria ka detyrimin të përafrohet me rregulloret përkatëse evropiane që rregullojnë tregun e Ditës në Avancë (*Day-Ahead Market*).

- Në këtë drejtim, platforma ALPEX duhet të jetë teknikisht e përgatitur për operimin në interval kohor 15-minutësh, në përputhje me zhvillimet në vendet pjesëmarrëse të BE-së. Kjo reformë vlerësohet se do të përmirësojë efikasitetin, fleksibilitetin dhe saktësinë e operacioneve të tregut, si dhe do të ndihmojë në integrimin më të mirë të burimeve të rinovueshme të energjisë.

- “OST” sh.a., në vijim të komunikimeve, ka informuar ERE-n se Komiteti Drejtues i Tregut të Përbashkët Evropian ka vendosur shtyrjen e datës për fillimin e zbatimit të intervalit 15-minutësh në SDAC, nga 11 qershor në 30 shtator 2025, me ditën e parë të tregtimit për lëvrim më 1 tetor 2025.

- Gjatë mbledhjes së Bordit, përfaqësuesit e “OST” sh.a., ndër të tjera, informuan se ky komunikim i “OST” sh.a. kishte qëllim informues dhe se vendimi i Komitetit Drejtues të Tregut të Përbashkët Evropian për shtyrjen e datës për fillimin e zbatimit të intervalit 15-minutësh në SDAC nuk i referohet tregut të brendshëm të energjisë elektrike në vendin tonë.

- Në këtë kuadër, ERE vlerëson se zgjatja e efekteve juridike të vendimit nr. 45, datë 27.2.2025, do të krijonte hapësirën e nevojshme për OSHB-të dhe aktorët e tjerë të tregut të balancimit që të ndërmarrin përgatitjet teknike të domosdoshme për kalimin efektiv në intervalin kohor 15-minutësh.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Zgjatjen e efekteve juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 45, datë 17.2.2025, deri më datë 31.12.2025.

2. “OST” sh.a. të raportojë çdo muaj në ERE dhe të kryejë testimet përkatëse me pjesëtarët e tregut, operatorët e bursës dhe me OST-të fqinje për implementimin e intervalit kohor 15-minutësh.

3. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Mbikëqyrjes së të Licencuarve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data

e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM Nr. 118, datë 3.6.2025

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 283, DATË 18.12.2024, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘MOUNTAIN’S GREEN ENERGY’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.6.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme me nr. 1740 prot., datë 2.6.2025, “Mbi ndryshimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 283, datë 18.12.2024, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 283, datë 18.12.2024, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Mountain’s Green Energy’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 1 975 kw””, konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Mountain’s Green Energy” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 283, datë 18.12.2024, ka miratuar licencimin e shoqërinë “Mountain’s Green Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 1 975 kw, me



vendndodhje në Gomsiqe, Bashkia Vau i Dejës, për një afat 30-vjeçar. Vendimi parashikon që, përpara fillimit të operimit, shoqëria të dokumentojë testimin e veprës pranë ERE-s dhe se vendimi mund të rishikohet në funksion të këtij plotësimi.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Shoqëria “Mountain’s Green Energy” sh.p.k., me shkresën nr. ekstra prot., datë 21.5.2025, protokolluar në ERE me nr. 1740 prot., datë 21.5.2025, ka paraqitur pranë ERE-s kërkesën për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 283, datë 18.12.2024, në funksion të përmbushjes së detyrimit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi.

- Në kuadër të plotësimit të këtij kushti, shoqëria ka përcjellë dokumentacionin përkatës, përfshirë: procesverbalin e përfundimit të punimeve, të datës 15.12.2024; aplikimin për pajisje me certifikatën e pranimit të veprës, drejtuar Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), me shkresën e datës 17.2.2025, protokolluar në AKBN me nr. 1028 prot., datë 18.2.2025; si dhe raportin e testimit të veprës, të kryer nga vetë shoqëria “Mountain’s Green Energy” sh.p.k.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Në përputhje me nenin 10 të kontratës koncesionare nr. 9112 rep., nr. 3449 kol., datë 29.12.2017, të ndryshuar, ndërmjet autoritetit kontraktor dhe shoqërisë “Mountain’s Green Energy” sh.p.k., për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaiik “Gomsiqë” me kapacitet prodhues 1975 kw, në Bashkinë Vau i Dejës, qarku Shkodër, është parashikuar se procesi i testimit të veprës realizohet me pjesëmarrjen e autoritetit përgjegjës, që është Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN).

- Në kushtet kur brenda afatit të përcaktuar në pikën 3 të nenit 10 të kontratës, pas njoftimit zyrtar drejtuar AKBN-së me shkresën nr. 1028 prot., datë 18.2.2025, nuk është kryer testimi nga ana e autoritetit përgjegjës, testimi i veprës është realizuar nga vetë Mbajtësi i Miratimit për Ndërtim, “Mountain’s Green Energy” sh.p.k., në bashkëpunim me sipërmarrësin e punimeve “Vega Energy” sh.p.k. dhe mbikëqyrësin e punimeve “Infinite R.S.” sh.p.k.

- Me e-mail-in e datës 30.5.2025, ERE i ka kërkuar shoqërisë “Mountain’s Green Energy” sh.p.k. informacion lidhur me zbatimin e detyrimeve të kontratës koncesionare, përkatësisht mbi njoftimin

e autoritetit kontraktor për qëllime testimi. Në përgjigje të këtij komunikimi shoqëria ka sqaruar, se bazuar në pikën 3 të nenit 10 të kontratës dhe në përputhje me VKM-në nr. 506, datë 1.8.2024, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 547, datë 9.8.2006, të Këshillit të Ministrave”, nëse pas 45 ditëve nga njoftimi zyrtar autoriteti përgjegjës nuk kryen testimin, vepra konsiderohet e testuar.

- Përveç dokumentacionit të mësipërm, shoqëria ka përcjellë pranë ERE-s me shkresat e protokolluara me nr. 1740/1 prot., dhe nr. 1740/2 prot., datë 29.5.2025, edhe testimin 72-orësh të realizuar nga OSSH sh.a., bazuar në shkresën nr. 4607/5 prot., datë 19.5.2025, me lëndë “Mbi dhënien e tensionit për qëllime testimi me ngarkesë në rrjetin e transmetimit të linjës 35 kV”, procesverbalin mbi vendosjen e matësit të datës 22.5.2025, si dhe kërkesën për lidhje përfundimtare me rrjetin e linjës 35 kV për centralin fotovoltaiik “Mountain’s Green Energy” sh.p.k., me kapacitet 1975 kw.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në funksion të sa parashtruar më sipër, vlerësohet se kushti i vendosur në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE nr. 283, datë 18.12.2024, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Mountain’s Green Energy’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, është përmbushur nga ana e shoqërisë “Mountain’s Green Energy” sh.p.k., dhe si i tillë duhet të shfuqizohet nga Enti Rregullator i Energjisë.

- Në rast se MIE do të ketë kundërshtime lidhur me procedurën e ndjekur nga shoqëria “Mountain’s Green Energy” sh.p.k., lidhur me njoftimin për testimin e veprës, pika 3 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 283, datë 18.12.2024, ka parashikuar rishikimin e këtij vendimi.

- Bazuar në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ku përcaktohet se një akt administrativ mund të anulohet, apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj, vlerësojmë që pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 283, datë 18.12.2024, duhet të shfuqizohet pasi shoqëria “Mountain’s Green Energy” sh.p.k. ka përmbushur kushtin e vendosur nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 283, datë 18.12.2024, shfuqizohet.

2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë “Mountain’s Green Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, FITL sh.a., OSSH sh.a. lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Shtetasi Isuf Kucaj, kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, shpalljen të vdekur të shtetasit Skender Kuca, i biri i Halilit dhe i Bedrijs, lindur më 2.2.1959.

KËRKUES
Isuf Kucaj

KËRKESË

Shtetasi Skënder Birçe kërkon, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, shpalljen e zhdukjes së shtetasve Agim Birçe, i biri i Xhemal dhe Xhene, i datëlindjes 8.4.1946 dhe Xhevrije Birçe, e bija e Osmanit dhe Haxhires, e datëlindjes 18.6.1948.

KËRKUES
Skënder Birçe

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në ligjin nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 9, datë 17.1.2025, bëhet korrigjimi i gabimeve materiale si më poshtë:

1. Në germën “e”, të pikës 1, të nenit 27, të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i cili rregullon detyrimin për të dokumentuar të kontrolluesit dhe përpunuesit, citohet gabimisht termi **“përpunues”**, në vend të termit **“kontrollues”**. Më konkretisht, germa “e” citon: “nëse është e mundur, një përshkrim të përgjithshëm të masave teknike dhe organizative të sigurisë, të zbatuara në ambientet **e përpunuesit**”.

Nga fryma e kësaj pike rezulton e qartë që saktësimi është në të njëjtën frymë me vullnetin e ligjvënësve, pasi referenca është për kontrolluesin, ku pika 1 në tërësi rregullon detyrimin e këtij të fundit për të dokumentuar, ndërkohë që detyrimi për përpunuesin përcaktohet në pikën 2 të këtij neni.

Sa më sipër, në germën “e”, të pikës 1, të nenit 27 fjala **“përpunuesit”** të zëvendësohet me **“kontrolluesit”**.

2. Në rreshtin e dytë, të pikës 1, të nenit 60, të ligjit, numri **“25”** duhet të zëvendësohet me numrin **“26”**, pasi nga përmbajtja e nenit në fjalë kuptohet qartë që referenca është për nenin 26, i cili rregullon pikërisht marrëdhënien me përpunuesin.

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 80 lekë

